

VENDIM
Nr. 198, datë 15.8.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 25 mw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 278, datë 6.11.2025; nr. 147, datë 28.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 15.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/8 prot., datë 13.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Power Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Power Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1923 prot., datë 23.6.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 134, datë 7.7.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.7.2025 dhe 9.7.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.8.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1923/4 prot., datë 9.7.2025, ku po ashtu i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- ERE, me shkresën nr. 1923/3 prot., datë 9.7.2025, dhe me *email*-in e datës 15.7.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/ dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1923/7 prot., datë 30.7.2025, ka depozituar informacionin/dokumentacionin plotësues për këtë aplikim.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.1, gerrat: “a”, “b”, “d”, “e” dhe “f”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria “Power Energy” është pajisur me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 310, datë 4.6.2025, “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier”.

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 3038, Njësia Administrative Dërmena, fshati Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Power Energy’ sh.p.k”.

- Ka depozituar vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 17.2.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Centrali Fotovoltaike ‘Power Energy Solar’ 25 mw”, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, Shqipëri.

Kushtet dhe afatet ligjore

- Në nenin 4 të kontratës së nënshkruar me MIE-n nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.6.2025, përcaktohet se ajo lidhet për një afat 49-vjeçar, nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje. ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë 30-vjeçare të performancës për panelet fotovoltaike, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes së centralit fotovoltaike me rrjetin e transmetimit, rezulton se shoqëria është brenda afatit të përcaktuar në miratimin në parim të dhënë nga “OST” sh.a. nëpërmjet shkresës së datës 10.2.2025, por duke qenë se nuk është pajisur ende me miratimin përfundimtar apo nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse, duke marrë në konsideratë dhe faktin që me marrjen e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltaike, lidhja e tij me rrjetin elektrik është i garantuar, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE marrëveshjen e pikës së lidhjes të nënshkruar me “OST” sh.a.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më datë 17.2.2027, periudhë kjo brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n, ku përcaktohet se duhet të ndërtojë dhe të vendosë në punë centralin brenda datës 4.6.2028. Në këto rrethana dhe duke marrë në konsideratë faktin se vetë shoqëria ka parashikuar që të vendosë në operim centralin muajit dhjetor 2025, vlerësohet që t’i lihet kusht që të dokumentojë në ERE fillimin e operimit të centralit fotovoltaike brenda datës 31.12.2025.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës. Brenda këtij afati vlerësohet që t’i lihet asaj detyrë që të përditësojë në ERE dhe informacionin përkatës për strukturën organizative.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë më sipër dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 25 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shoqëria të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 4.6.2028.*

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

5. *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Power Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti